



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Teknika të shprehjes dhe të Komunikimit
Në Gjuhën Frënge

Ngarkesa: 4 kredite E.C.T.S., leksione 30 orë , seminare 10 orë

Viti / Semestri: Viti III, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhën Frënge “Gjuhë dhe Komunikim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të zbatojë parimet bazë të teorisë së komunikimit në rrethanat e ndryshme të ligjërimit. Të rrisë nivelin e përvetësimit të gjuhës frënge. Të aftësohet në përdorimin strukturave bazë të gjuhës frënge sipas situatave të veçanta të ligjërimit. Të përditësojë fjalorin terminologjik të fushës me të rejat më të fundit. Të njihet me zbatimin e teknikave të komunikimit në fushat e ndryshme të dijes. Të përgatitet për punë të pavarur shkencore. Të aftësohet për të lexuar, folur dhe dëgjuar në situata të ndryshme komunikimi.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

1. të përvetësojë dhe të aftësohet në zbatimin në praktikë të koncepteve bazë të teorisë së informimit dhe të komunikimit.
2. të njohë në praktikë rregullat e funksionimit të gjuhës dhe se si ato zbatohen në ligjërimet e ndryshme të saj.
3. Të strukturojë dhe të organizojë të shprehurin duke ja përshtatur atë situatës së komunikimit.
4. Të përgatisë ligjëratën e tij nisur nga një skemë e përpunuar paraprakisht.
5. Të shprehet lirshëm në grup me synim realizimin e një objekti të mirëpërcaktuar.
6. Të mësohet të negociojë dhe të argumentojë; të ndërgjegjësohet për nuancat shprehëse të mesazhit.